



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E drejta e Sigurimeve

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta e Sigurimeve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i IV -të, semestri i VII-të
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: (L) Gr.1 14:00-15:30 (E premte) Salla:A25
Mësimdhënësi i lëndës:	Gani ASLLANI
Detajet kontaktuese:	Tel: +37744213250 , E-maili: gani.asllani@unhz.eu
Përshkrimi i lëndës	Njoftimi, përgaditja dhe aftësimi i juristeve të ardhshëm në fushën e sigurimeve, njohjen me parimet bazë të sigurimeve, subjekteve të sigurimit, rregullimin e tregut të sigurimeve, natyrën institucionale të funksionimit të tyre, rregullativen ligjore, kontratat dhe përgaditja e tyre, polisa e sigurimit, llojet e sigurimeve, aftësimin dhe interpretimin e dispozitave në fushën e sigurimeve dhe çështjeve të tjera me interes për studentët.
Qëllimet e lëndës:	E Drejta e Sigurimeve përfshinë të gjitha rregullat juridike sipas të cilave bëhet mbrojtja dhe realizimi i të drejtave subjektive të cilat lindin nga marrëdhëniet juridiko-civile të sigurimeve. Është lëndë e formimit special që synon të ofrojë përgatitje dhe aftësim profesional në fushën e sigurimeve, fushë e cila gjithnjë e më tepër përfshinë shumë subjekte të cilat sigurohen nga rreziqet e ndryshme. Zhvillimi i hovshëm industrial ka ndikuar që sigurimet dhe mbrojtja me anë të sigurimeve të paraqet imperativ dhe domosdoshmëri të kohës. Qëndrim i secilit person ndaj rrezikut është i ndryshëm. Prandaj, ne të gjithë reagojmë ndaj rrezikut në mënyra të ndryshme. Disa njerëz janë të gatshëm t'i bartin disa rreziqe vetë prandaj edhe njihen si 'rrezik-pranues', kurse të tjerët anojnë më tepër nga të qenit 'rrezik-shmangës', duke u ndier më të lumtur duke minimizuar rrezikun të cilit i janë të ekspozuar (mbase duke e transferuar rrezikun, sikur në sigurim). Në këtë modul, studentëve të kursit u ofrohet një njohuri, formim dhe studim mbi format dhe llojet e sigurimeve, mënyrën e të siguruarit, rreziqet dhe llojet e rreziqeve, rasti i siguruar, shuma e siguruar, shpërblimi i sigurimit etj. Gjithashtu studentët njihen edhe me

	legjislacionin në fuqi sa i përket sigurimeve dhe të drejtës subjektive nga sigurimet. Me anë të këtij kursi studentëve iu ofrohen njohuri të bollshme në lidhje me trendet e sigurimeve në botë, në mënyrë të veçantë në Evropë dhe vendet e rajonit.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	1. Të fitoj njohuri në fushën e të drejtës së Sigurimeve dhe trendët globale në fushën e industrisë së sigurimeve; 2. Të jetë në gjendje të krahasojë, njohë dhe kuptojë proceset e sigurimeve, rolit financiar të tyre në ekonominë e vendit dhe më gjerë; 3. Të fitoj njohuri shtesë lidhur me sigurimin, llojet e tyre, instrumentet e saja, dhe edhe çështje të tjera të rëndësishme në këtë fushë të rëndësishme; 4. Të jetë në gjendje të fitojë shkathhtësi analitike të vërejtjes së problemit, analizimit të tyre dhe gjetje të zgjidhjeve adekuate;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	5	10
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	2	5	10
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike, Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë temë apo punimi seminar. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund bëhet vlerësimi i punimit. Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në		

	dy ose më shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane: prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar.
Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 25 pikë Testi i dytë: 25 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (5 detyra x 2 pikë) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 30 pikë <u>Totali: 100 pikë.</u> Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	- Menaxhmenti i Rrezikut dhe Sigurimet, Dr. Xhevat Bakraçi, Prishtinë, 2007 - Doracak i trajnimeve për Sigurime. Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, Prishtinë, 2015 - Ekonomika Osiguranja, S. Andrijasevic- V. Petrenovic, Zagreb, 1999 - Ekonomika na Osigravanje, T. Janovski, Skopje, 1997
Literatura shtesë:	- Prof. Dr. Igor Tomes, “E drejta e sigurimit social”, 1998 - Raport për përfitimet afatshkurtra në sistemin e sigurimeve shoqërore, ILO Budapest, 2005 - Leverett J. “ Risk menaxhment and insurance” Athens, GA. University of Georgia, - Altman, I, E, Handbook of Financial Markets and institutions, John Wiley and Sons, New York, 1989 - Raport për zhvillimet e marrëveshjeve bilaterale në fushën e sigurimeve shoqërore, ILO Budapest, 2005 - AWT International – Macedonia – presentation book. - Bobek, S. “Management” Ekonomski Fakultet, Skopje 1999. - Kotler P. & Armstrong G. “Principles of marketing” ninth ed. Prentice Hall 2001. - Miladinovski S. “Marketingu” Fakulteti Ekonomik, Prilep, 1996. - Perreault, D. William, Jr. & McCarthy, E. Jerome “Basic Marketing” Irwin/McGraw-Hill, 1999.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në të Dejtën e Sigurimeve. Koncepti dhe përmbajtja e saj. Dallimi në mes sigurimit social nga ai premisor. Parimet e ekonomisë së sigurimeve.
<i>Java e dytë:</i>	Zhvillimi historik i sigurimeve, zhvillimi i risigurimeve. Dëmet ekonomike, prevenca dhe sigurimi.
<i>Java e tretë:</i>	Funksionet e sigurimeve, organizimi institucional i institucioneve të sigurimit.
<i>Java e katërt:</i>	Ndërmjetsuesit në sigurime. Brokerët, maklerët, komisionarët e avarive, agjentët dhe agencionet në sigurime.
<i>Java e pestë:</i>	Premitë e sigurimeve. Koncepti, rëndësia dhe llojet e tyre, tarifat dhe pagesat e premive të sigurimeve, bonusi, mallusi dhe franshiza.
<i>Java e gjashtë:</i>	Menaxhimi i rrezikut dhe organizimi i teknikës së sigurimeve. Metodatat e menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rreziqeve financiare.
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i Parë
<i>Java e tetë:</i>	Kontratat dhe dokumentet në sigurime. Natyra juridike e kontratës, parimet e kontratave në sigurime, llojet e kontratave në sigurime.
<i>Java e nëntë:</i>	Llojet e sigurimeve.
<i>Java e dhjetë:</i>	Ndarja e sigurimeve sipas specifikave të tjera. Sigurimi Vullnetar dhe i Obligueshëm.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Bashkësigurimi dhe risigurimi. Koncepti dhe rëndësia e tyre. Llojet e tyre. Marrëveshjet për risigurime.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Mjete, fondet, afarizmi financiar në sigurime. Burimet e mjeteve të sigurimit.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Marketingu në industrinë e sigurimeve. Koncepti i marketingut. Tregu i sigurimeve.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Pozita e sigurimit në ekonominë kombëtare. Karakteristikat ndërkombëtare të sigurimit. Zhvillimi i sigurimeve në Kosovë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi Përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollë, - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore, - Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim, - Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit